



USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA



Buletini V

30 Mars 2015

INPO ka vazhduar monitorimin e Gjykatës Themelore në Ferizaj, degët në Kaçanik dhe në Shtërpçë, në kuadër të projektit “Ngritja e vetëdijës dhe pjesëmarrjes së qytetarëve në sistemin gjyqësor”. Gjatë periudhës, 15 Shkurt - 02 Mars janë monitoruar gjithsej dymbëdhjetë seanca, prej tyre tetë (8) seanca të lëmisë penale, katër (4) për çështje civile. Në këto seanca gjyqësore është vërejtur një rënie e pjesëmarrjes së qytetarëve për t’i ndjekur për së afërmi proceset gjyqësore.

Të dhëna statistikore:

Pjesëmarrja e qytetarëve në seanca sipas çështjes:

Çështja e Gjykuar	Numri i pjesëmarrësve
Vepër Penale	20
Kontest Civil	15

Broshura “Ta njohim Gjykatën tonë”

Në fund të muajit shkurt, INPO realizoi aktivitetin e informimit të qytetarëve lidhur me funksionimin e sistemit të drejtësisë, konkretisht gjyqësorit, prokurorisë dhe avokatisë sipas sistemit të ri të drejtësisë. Ky aktivitet u zhvillua në komunën e Ferizajt, Kaçanikut, Hanit të Elezit dhe Shtëmës.

Si mjet i informimit u përdor një broshurë e përgatitur nga INPO në të cilën janë prezantuar informata të nevojshme lidhur me sistemin e ri të drejtësisë,

integritetin e gjykatësit, prokurorit dhe avokatit. Përmes këtij aktiviteti INPO dëshiron të informoj qytetarët lidhur me sistemin e ri gjyqësor dhe me integritetin e gjykatësve, prokurorve dhe avokatve.

Greva e Gjyqësorit

Që prej datës 3 Mars 2015, kur edhe ka filluar greva e gjykatësve e deri më tani në Gjykatën Themelore të Ferizajt janë shtyer mbi 300 seanca gjyqësore. Një gjë e tillë ka ndikuar keq në procesin e rregullt të funksionimit të Gjykatës, duke pas parasysh që Gjykata Themelore në Ferizaj ka mbi 20 mijë lëndë të ende të pazgjidhura, që presin në sirtarët e gjykatësve.

Kjo grevë po ndikon negativisht duke shkelur kështu të drejtat fundamentale të njeriut, specifikisht tek senacat të cilat janë në proces e që janë të lidhura me paraburgim.

INPO vlerëson se kjo ndërprerje e procesit të rregullt rrezikon mospërbushjen e obligimeve kushtetuese dhe ligjore në mbrojtjen dhe ofrimin e sigurisë juridike të qytetarëve të Kosovës, dhe bën thirrje që të arrihet sa më shpejtë një zgjidhje brenda një afati sa më të shkurtë dhe të arsyeshëm.

Iniciativa për Progres, Projekti “Ngritja e vetëdijës dhe pjesëmarrjes së qytetarëve në sistemin gjyqësor”

“Ky buletin u mundësua me përkrahjen bujare të popullit amerikan përmes Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombtar (USAID). Përmbajtja është përgjegjësi e INPO-s dhe nuk pasqyron deomos pikëpamjet e USAID-it apo të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara”